

VENDIM
Nr.855, datë 17.12.2004

PËR ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE NGA SHITJA E AKTIVEVE TË QËNDRUESHME, TË TRUPËZUARA TË SHOQËRIVE ANONIME, ME KAPITAL THEMELTAR TËRËSISHT SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 22 e 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, veprimtarive të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, të nenit 10 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar dhe të nenit 164 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shitja e aktiveve të qëndrueshme, të trupëzuara të shoqërive anonime, me kapital themeltar tërësisht shtetëror, kur ato nuk i shërbejnë më veprimtarisë së tyre, të realizohet me ankand, në lekë, nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit:

a) Për pasuritë e luajtshme, miratimi i privatizimit të kryhet nga organi që i administron ato.

b) Për objektet ndërtimore, miratimi i privatizimit të bëhet nga Ministri i Ekonomisë. Ministri i Ekonomisë në urdhrin për privatizimin e objektit, pjesë e kapitalit të shoqërisë tregtare urdhëron kryerjen e veprimeve në regjistrin tregtar, për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë.

Procedura për kryerjen e veprimeve në regjistrin tregtar për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, për objektet ndërtimore, dosjet e vlerësimit të të cilave, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndodhen në Ministrinë e Ekonomisë dhe në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, të bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitjes.

2. Procedurat e vlerësimit dhe të shitjes të realizohen në përputhje me vendimin nr.159, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe për procedurat e shitjes”.

3. Të ardhurat e përfituara:

a) nga shitja e pasurive të luajtshme të ndahen si më poshtë vijon:

- 5 për qind për llogari të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;

- 95 për qind për llogari të shoqërisë anonime;

b) nga shitja e objekteve ndërtimore të shoqërive anonime me kapital themeltar tërësisht shtetëror të ndahen si më poshtë vijon:

- 5 për qind për llogari të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;

- 10 për qind për llogari të Ministrisë së Ekonomisë; 85 për qind për llogari të Buxhetit të Shtetit.

4. Regjistrimet për shitjet e aktiveve të qëndrueshme, të trupëzuara, si veprim me efekt në rezultatin e shoqërisë anonime, të bëhen në përputhje me ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

5. Vendimi nr.417, datë 9.7.1998 i Këshillit të Ministrave “Për administrimin e të ardhurave nga shitja e aktiveve të qëndrueshme, të trupëzuara, të shoqërive anonime, me kapital themeltar tërësisht shtetëror”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano